



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr.  
Prishtinë, më 3.03.2010, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi. Haki Shatri, Besa Gaxheri, Mufera Sinik dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Gani Koci dhe Suzana Novobërdaliu.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Dritë Kadriu, zëvendëse e kryetarit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Teknologji, Rini dhe Sport, Mustafë Xhemajli, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Shyqëri Hyseni nga MEF-i, Teki Shala, Alexander Beetz, Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Ahtere Loxha dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Naser Osmani, zëvendëskryetar parë i komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 10.02.2010,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente, Të ftuar:**  
**Dritë Kadriu, zëvendëse e kryetarit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Teknologji, Rini dhe Sport**  
**Mustafë Xhemajli, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës,**  
**Agim Krasniqi, drejtor i buxhetit (MEF)**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente,**

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri, me amendamente,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informative dhe verifikimin e sigurisë, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente,
8. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet postare, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente,
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/108, të datës 04.02.2010, dhe Përfundimit të Kryesisë nr.03-P-193, datë 19.02.2010, për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
10. Informatë në lidhje me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,
11. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 10.02.2010

**Kryesuesi** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 10.02.2010, pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente

**Kryesuesi** theksoi se projektligji përmban implikime buxhetore në vlerë prej 1,110,000 euro, dhe se kjo mjete nuk janë të parapara në buxhet dhe as në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Arsyeja e kësaj kostoje është struktura e re e agjencionit dhe formimi i dy qendrave kulturore.

**Dritë Kadriu** njoftoi se si komision funksional kemi amendamentuar projektligjin në përmbajtje në ato pjesë ku është vlerësuar se ka nevojë për ndryshime. Sa i përket ndikimeve buxhetore, kostoja shtesë e parashikuar nga MEF, duhet të përballohet nga buxheti i Kosovës dhe nuk duhet të jetë pengesë për miratimin dhe zbatimin e tij.

**Kryesuesi** konstatoi se projektligjin mund ta rekomandojmë për miratim, vetëm nëse Qeveria siguron mjete të mjaftueshme financiare për implementimin e tij.

**Mustafë Xhemajli** me rastin e përgatitjes së deklaratës financiare kemi prezantuar implikimet buxhetore që përmban ligji dhe mosparashikimi i tyre me buxhet. Nuk kemi marrë informacione shtesë nga draftuesi i këtij projektligji dhe si i tillë kërkon një kosto shtesë për implementim. Nëse

projektligji aprovohet nga Kuvendi, do të duhej që MEF-i dhe Qeveria të sigurojnë mjete financiare për zbatimin e tij.

**Besa Gaxherri** theksoi se ndodhemi para një akti jo të mirë, Qeveria ka propozuar projektligjin për miratim, ndërsa nuk ka parashikuar mjete për zbatimin e tij. Propozoi që si komision të bëjmë një amendament që projektligji të fillojë të zbatohet në vitin 2011 dhe ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e tij. Përgatitjet të bëhen më herët dhe Qeveria duhet të sigurojë mjetet për implementimin e tij.

**Armend Zemaj** theksoi se miratimi i projektligjit është i veçantë, për shkak të rëndësisë që ka trajtimi i mërgatës me vendin amë. Projektligji duhet të kalojë, për arsye se edhe ashtu krijimi i qendrave kulturore jashtë vendit dhe konsolidimi i agjencionit do të marrë kohë, ndërsa Qeveria në gjashtëmujorin e dytë të ndajë mjete për implementimin e tij. Ato do të mund të siguroheshin edhe nga fondi rezervë për krijimin e institucioneve të reja.

**Safete Hadërgjonaj** pyeti a i'u është dërguar me kohë ftesa për pjesëmarrje në mbledhje përfaqësuesit nga Qeveria, i cili thotë se është i papërgatitur për këtë takim. Megjithatë duke pasur parasysh ekzistimin e departamentit, ekzistojnë parakushte për miratimin e këtij projektligji dhe fillimin e implementimit të tij. Ndërsa ne si komision mund të bëjmë një amendament që formimi i qendrave të reja kulturore të fillojë në vitin 2010, për funksionalizimin e të cilave Qeveria do të duhej të sigurojë mjetet të mjaftueshme buxhetore.

**Haki Shatri** theksoi se me themelimin e agjencionit është paraparë shuarje e zyrës për mërgatën dhe si rezultat kalimi i stafit dhe i mjeteve buxhetore. Ndryshimi është rreth 300.000€. Për buxheti e Kosovës nuk janë të papërbalueshme këto mjete, për implementimin e këtij ligji. Jam për miratimin e projektligjit.

**Xhevdet Neziraj** theksoi se shumica e projektligjeve, të cilat kanë implikime buxhetore po lihen në rishikim të buxhetit, dhe si rezultat mund të paraqiten situata që janë të papërbalueshme për buxhetin e vendit.

**Hajdin Abazi** vlerësoi rëndësinë e miratimit të projektligjit. Duke pasur parasysh potencialin e madhë të mërgatës, edhe përkundër implikimeve buxhetore, të cilat mund të jenë të përbalueshme për buxhetin e Kosovës, do të duhej gjetur instrumentet për zbatimin e tij. Në këtë mënyrë do të ndihmohet mërgata jonë por edhe do të përfitonim shumë edhe si vend. Jam për miratimin e tij dhe Qeveria duhet t'i gjejë mjetet për zbatimin e projektligjit.

**Kosara Nikolic** theksoi se askush nuk mund të thotë se projektligji nuk është i rëndësishëm për Kosovën. Deri më tani në Komision shumë herë kemi biseduar për krijimin e agjencioneve në fusha të ndryshme, për të cilat nuk janë planifikuar mjete buxhetore për funksionalizimin e tyre, poashtu është situata e njëjtë edhe krijimin e këtij agjencioni. Në këtë kontekst duhet të kemi qëndrim unik dhe të rekomandojmë miratimin e këtij projektligji, por gjatë hartimit të rregullatives ligjore, është dashur që të parashihen dhe sigurohen mjete buxhetore për implementimin e tij.

**Armend Zemaj** tërhoqi vëmendjen se në amendamentin 8 të propozuar nga komisioni funksional, të përbërja e komisionit, deputetë nuk mund të jenë në pozitën e panelit për përzgjedhjen e shërbyesve civil. Duhet të përcaktohet qartë se kush duhet të jetë anëtarë i këtij komisioni, duhet të jenë figura eminente dhe jopolitike që përfaqësojnë mërgatën e Kosovës.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Projektligji për Mërgatën e Kosovës përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. I rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, dhe të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në fazën e rishikimit të buxhetit për vitin 2010, të sigurojë mjete të mjaftueshme buxhetore, për implementimin e këtij ligji.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryesuesi** kemi shqyrtuar projektligjin dhe i kemi përafuar mendimet.

**Haki Shatri** theksoi se amendamenti 11 duhet të jetë Mjetet financiare për kompenzim të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Propozimi u përkrah njëzëri.

Pas propozimit, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, dhe ka konstatuar se projektligji nuk përmban implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë atë.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit t'i miratojë ato, me përjashtim të amendamentit 8, 10, 11, 17 dhe 29 të komisionit funksional.
- III. I rekomandohet Kuvendit të miratojë amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa të pasqyruara si në vijim:

### **Amendamenti 1**

Neni 14, riformulohet si në vijim:

#### **Neni 14 Përfitimet financiare dhe materiale të deputetit**

***Deputeti gjatë ushtrimit të mandatit të tij ka të drejtë kompenzimi për:***

- a) ***Paga bazë;***
- b) ***Paga kalimtare pas përfundimit të mandatit;***
- c) ***Kompenzimi për pjesëmarrje në seanca dhe në takime të komisioneve ;***
- d) ***Kompenzim për funksionet parlamentare;***
- e) ***Kompenzimi i shpenzimeve mujore;***

- f) *Pensionet suplementare; dhe*
- g) *Të drejtat tjera të përcaktuar me këtë ligj.*

## **Amendamenti 2**

Neni 15, riformulohet si në vijim:

### **Neni 15 Kompensimi i deputetit**

***Paga bazë e deputetit do të përcaktohet me dispozitat e Ligjit për pagat e funksionareve publik.***

## **Amendamenti 3**

Neni 17.2. fshihet në tërësi

## **Amendamenti 4**

Neni 18, riformulohet si në vijim:

### **Neni 18 Kompensimi për funksion**

**18.1. Deputeti që mbanë funksione parlamentare merr kompensim shtesë e cila përcaktohet me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe vendim të Kryetarit të Kuvendit.**

**18.2. Deputeti nga paragrafi 1 i këtij neni ka të drejtë kompensimi shtesë vetëm për një funksion udhëheqës.**

## **Amendamenti 5**

### **Neni 19 Ndalesa e kompensimit**

Neni 19, rreshtin e tretë fjalia “nga neni 17 dhe 18 i këtij ligji” zëvendësohet me fjalinë si në vijim “nga neni 14 pika c) dhe e) i këtij ligji”

## **Amendamenti 6**

Neni 20 riformulohet si në vijim:

### **Neni 20 Përcaktimi i lartësisë së kompensimeve**

**Lartësia e kompensimit për funksione dhe shpenzime mujore, përcaktohen me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe vendim të Kryetarit të Kuvendit.**

## **Amendamenti 7**

Neni 22, në fund të paragrafit 22.2 fjala “kompensimi bazë” ndryshohet me fjalën “paga bazë.”

(Ky ndryshim reflektohet në tërë tekstin e këtij projektligji)

## **Amendamenti 8**

### **Neni 24 Baza e pensionit**

Neni 24, paragrafi 24.1, rreshtin e parë shprehja “shërben kompenzimi i deputetit” ndryshohet në shprehjen “shërben paga bazë aktuale e deputeti.”

Paragrafi 24.2 riformulohet si në vijim:

**24.2. Shuma e përgjithshme e pensionit suplementar në asnjë rast nuk mund të jetë më e madhe se 70% (shtatëdhjetë përqind) e pagës bazë të deputetit.**

## **Amendamenti 9**

Neni 26, paragrafi 26.2 fshihet në tërësi

## **Amendamenti 10**

### **Neni 27 Pensioni familjar**

Neni 27, shtohen dy paragraf të ri 27.4 dhe 27.5 si në vijim:

**27.4 Të drejtë për pensionin familjar e kanë bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare.  
27.5 Përrjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni fëmijët të cilët vazhdojnë shkollimin do të përfitojnë deri në moshën 22 vjeçare.**

## **Amendamenti 11**

Neni 28, riformulohet si në vijim:

### **Neni 28 Sigurimi i mjeteve**

**“Mjetet financiare për kompenzim të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.”**

## **Amendamenti 12**

### **Neni 51 Dhuratat**

Neni 51.1. riformulohet si në vijim:

**51.1. Deputeti gjatë mandatit të tij mund të pranoj dhurata, në pajtim me ligjin përkatës në fuqi.**

## Amendamenti 13

### Neni 56 Hyrja ne fuqi

Neni 56, riformulohet si në vijim:

**Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2011.**

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informative dhe verifikimin e sigurisë, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Projektligji për klasifikimin e informative dhe verifikimin e sigurisë, nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **7. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Projektligji për mjekësinë ligjore nuk përmban implikime buxhetore.

- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**8. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet postare, me raportin e Komisionit funksional-Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

**R E K O M A N D I M**

- I. Projektligji për shërbimet postare nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/108, të datës 04.02.2010, dhe Përfundimit të Kryesisë nr.03-P-193, datë 19.02.2010, për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave**

Shtyhet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

**10. Informatë në lidhje me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010**

**Mufera Sinik** njoftoi se me rastin e miratimit të buxhetit 2010, në Komunën e Prizrenit në kuadër të Ministrisë së Arsimit janë paraparë 11 projekte, ndërsa me këtë ndryshim vetëm dy.

**Haki Shatri** theksoi se informata është e mangët dhe nuk përmbush kushtet e parapara në nenin 7.1 të Ligjit të Buxhetit 2010. Qeveria nuk është dashur të ndërroj tabelat e buxhetit siq ka bërë në kategorinë subvencione dhe transfere (prej 250.000€), pa miratimin e Kuvendit. Informata do sqarime shtesë për këto çështje.

Shtyhet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

**Përgatiti:**

Njësia për mbështetjen e Komisioneve

**Kryesuesi i Komisionit**

Naser Osmani

---